



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 223/5 prot.

Tiranë, më 3.6.2022

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 521, datë 1.4.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Erjon Shehaj
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijëni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datën 20.5.2022, është njoftuar vendimi nr. 521, datë 1.4.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin në rivlerësim z. Erjon Shehaj, me detyrë prokuror/drejtues në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor, nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 521, datë 1.4.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Erjon Shehaj, me dekret të Presidentit të Republikës, nr.7504, datë 4.6.2012, është emëruar prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë. Në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, subjekti i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin z. Shehaj ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale.
3. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni) ka administruar raportet e vlerësimit për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati

i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim referuar si KLP), nga të cilat rezulton se:

3.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Erjon Shehaj”, ka referuar:

- i. *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii. *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- iii. *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv. *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- v. *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

3.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin e përditësuar me nr. ***, datë **.12.2021¹, në vijim të raportit të parë, të përcjellë për përshtatshmërinë në vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, me informacionin shtesë të ardhur nga autoritetet verifikuese, në kohështrirje gjatë periudhës së rivlerësimit mbi përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, në formën e shpërdorimit të detyrës.

3.2.1 DSIK ka gjykuar që, për rastin në fjalë, konkluzioni të mbetet në vlerësimin e Komisionit në dritën e informacioneve të tjera, që mund të disponohen si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ që po kryhen ndaj subjektit të rivlerësimit.

3.3 KLP, bazuar në nenin 43, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit.

4. Përfundimet e Komisioni për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

4.1 ***Për vlerësimin e pasurisë.*** Komisioni ka vlerësuar se, nga analizimi i pasurive të subjektit, janë konstatuar disa pasaktësi në deklaram, në kuptim të ligjit nr. 9049/2003, por këto pasaktësi të konstatuara nuk e bëjnë të pamjaftueshëm deklaramin, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke arritur subjekti i rivlerësimit një nivel të besueshëm në kriterin e pasurisë.

4.2 ***Për kontrollin e figurës.*** Komisioni ka konkluduar se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016. Në funksion të verifikimit të informacioneve/sinjalizimeve të përfuara nga autoritetet verifikuese, Komisioni ka administruar disa dosje hetimore të hetuara nga subjekti i rivlerësimit, të cilat pas shqyrtimit dhe analizimit të tyre, u konsideruan të lidhura me kriterin profesional dhe janë paraqitur të integruara në seksionin e kriterit profesional, referuar si “Gjetje të tjera”, në vendimin përkatës.

4.3 ***Për vlerësimin e aftësive profesionale.*** Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59, pika 1, germa

¹ Deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë **.12.2021, të KDZH-së.

“c”, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

4.4 Në rrethanat konstatuese, jo vetëm të evidentimit të mangësive për dy çështje penale, por edhe të rrethanave specifike në vetvete që ato paraqesin, Komisioni ka vlerësuar se në zbatim të nenit 59, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, këto çështje duhet të transferohen pranë organit kompetent për inspektim, nëse verifikohen shkaqe që mund të përbëjnë shkelje disiplinore.

5. Në përfundim të procedurës së rivlerësimit, pas zhvillimit të seancave dëgjimore, Komisioni, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, dhe nenit 59, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndër të tjera, ka vendosur:

- *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Erjon Shehaj, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë.*
- *Bazuar në pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, transferimin pranë organit kompetent, për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, të dy dosjeve hetimore si më poshtë: a) lidhur me procedimin penal nr. ***/2014, për të cilin subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e procedimit penal ndaj të pandehurit, shtetasit ***.***, për veprën penale “Goditje për shkak të detyrës”. b) Lidhur me procedimin penal nr. ***/2015, me të pandehur shtetasin ***.***, për veprën penale “Kanosje e gjyqtarit”.*

II. Shkaqet e ankimit

6. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

7. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar si Kolegji).

8. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

9. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues, vlerësim të drejtë të provave, si dhe në përputhje me jurisprudencën orientuese të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

10. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, konstaton se nga shqyrtimi i vendimit nr. 521/2022, të Komisionit dhe akteve shoqëruese të tij, paraqiten gjetje dhe rrethana të tilla ligjore e fakti, që nuk përmbushin kriteret dhe standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes, që garantojnë mbrojtjen dhe forcimin e

besimit të publikut, të parashikuara me ligjin nr. 96/2016, duke përbërë në këtë mënyrë shkaqe për vlerësimin tërësor të procedurave, sipas përcaktimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

11. Rezulton se Komisioni ka evidentuar gjetje, në të gjitha burimet e vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, si: (i) raportin e vlerësimit të aftësive profesionale, të hartuar nga KLP-ja; (ii) raportin e përditësuar të organeve ndihmëse, (iii) ankesat/kallëzimet e regjistruara ndaj subjektit të rivlerësimit; (iv) denoncimet nga publiku, duke i kaluar barrë prove dhe kërkuar shpjegime, konkretisht, për procedimet penale të mëposhtme:

*i- procedimin penal nr.***, datë **.1.2015²;*

*ii- procedimin penal nr.***, datë **.10.2014³;*

*iii- procedimin penal nr.***, datë **.11.2020⁴;*

*iv- procedimin penal nr.***, datë **.7.2017⁵;*

*v- procedimin penal nr.***, datë **.3.2015⁶;*

*vi- procedimin penal nr.***, viti **.9.2018⁷;*

*vii- procedimin penal nr.***, datë **.12.2020⁸.*

12. Në referencë të arsyetimit të vendimit, pasi ka vlerësuar parashtrimet dhe shpjegimet e paraqitura, përkundrejt problematikave të verifikuara në këto procedime penale gjatë ushtrimit të funksionit të prokurorit, konstatohet se Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit arrin një nivel minimal kualifikimi sipas nenit 59, pika 1, germa “c”, të ligjit nr. 84/2016, dhe se ai duhet të konfirmohet në detyrë, duke transferuar procedimet penale nr. ***/2014 dhe nr. ***/2015 pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore.

13. Komisioneri Publik, në analizë të gjetjeve të vetë Komisionit mbi çështjet e mësipërme, vlerëson se problematikat e verifikuara në çështjet e analizuara, janë të tilla që cenojnë konkluzionin se subjekti arrin nivel minimal kualifikues sipas nenit 59, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, duke ekzistuar nevoja që ato të merren në shqyrtim në vlerësimin tërësor të procesit të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e këtij ligji.

14. Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 521, datë 1.4.2022, të Komisionit, ushtrohet në vlerësimin tërësor të procedurave, veçanërisht bazuar në gjetjet në rivlerësimin e kriterit të profesionalizmit⁹.

² Referohuni raportit të vlerësimit të aftësive profesionale, hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, për 5 dosje të shortuara.

³ Po aty.

⁴ Referohuni raportit të përditësuar nr. ***, datë **.12.2021.

⁵ Referohuni pjesëve të fashikullit të Komisionit, ankesa/denoncime.

⁶ Po aty.

⁷ Po aty.

⁸ Po aty.

⁹ Referohuni vendimit (JR) nr.19/2021, prg. 27.6 [...] Lidhur me pretendimin se neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, aplikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka ceduar në të tria kriteret e, për rrjedhojë, qëndrimi në detyrë i tij do të cenonte besimin e publikut, është i pabazuar. Gjuha e ligjit nuk e lidh aplikimin e këtij konkluzioni në formë kumulative me secilin prej kriterëve. Sipas përcaktimeve të ligjit nr. 84/2016, cenimi i besimit të publikut lidhet me vlerësimin tërësor, sipas kuptimit të nenit 4, pika 2 e ligjit, që përcakton vendimmarrjen në një ose disa kritere apo vlerësimin tërësor të procedurave. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar në ligj [...].

II. A Analiza e shkaqeve të ankimit

15. Përpara se të vijohet me trajtimin e çështjeve objekt ankimi dhe për të cilat Kolegjit do t'i kërkohet t'i shqyrtojë në zbatim të juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të njohur nga Kushtetuta, paraprkasht Komisioneri Publik çmon të sjellë në vëmendje jurisprudencën orientuese të Kolegjit, në lidhje me kryerjen e procesit të rivlerësimit, për sa i përket kriterit të aftësive profesionale, sipas përcaktimit të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, dhe logjikës së transferimit të çështjeve për inspektim.

16. Komisioneri Publik, referuar qëndrimit të mbajtur në jurisprudencën¹⁰ e Kolegjit, konstaton se disponimi i Komisionit për të transferuar dy nga çështjet penale të referuara pranë organit kompetent për inspektim, në juridiksionin e zakonshëm disiplinor, nuk është në pajtueshmëri me ligjin dhe aktet e administruara.

17. Kolegji, në jurisprudencën e tij orientuese, ka trajtuar dhe rastet e praktikave të transferuara, për të cilat ka arritur në konkluzionin, se atëherë kur mangësitë e subjekteve të rivlerësimit evidentohet se përsëriten në mënyrë të vazhdueshme dhe në praktika të ndryshme, ato përbëjnë përjashtim nga rastet e konfirmimit në detyrë dhe duhet të vlerësohen negativisht.

18. Kolegji, në këtë kuadër, njëkohësisht, ka arsyetuar dhe për elementin kohë, që duhet analizuar dhe vlerësuar në rastet kur Komisioni vendos për transferimin e çështjeve pranë organit kompetent të juridiksionit të zakonshëm disiplinor, teksa argumenton: [...] *Si rrjedhojë e kësaj logjike, praktikat të cilat transferohen për inspektim në organet kompetente, në parim duhet të përmbajnë shkelje joserioze, pa pasoja të rënda procedurale për palët, brenda afateve të parashikuara në nenin 117 të ligjit nr. 96/2016. Këto gabime nga Komisioni duhen vlerësuar sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit 4, pika 2 e të njëjtit ligj, dhe sipas nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji orienton Komisionin për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme¹¹[...].*

19. Në këto rrethana, Komisioneri Publik vlerëson se çështjet penale të transferuara nga Komisioni pranë organit kompetent të juridiksionit të zakonshëm disiplinor, që i përkasin viteve 2014 dhe 2015, janë *jashtë afatit 5-vjeçar nga koha kur ka ndodhur shkelja e pretenduar*, referuar parashikimit të nenit 117, të ligjit nr. 96/2016.

20. Transferimi i këtyre çështjeve nga Komisioni, për shkak të kalimit të afatit të parashkrimit, i përjashton ato, çështjet, nga mundësia që të vlerësohen nga organi kompetent, në juridiksionin e zakonshëm disiplinor, si dhe i shpëput nga gjetjet e tjera të rezultuara nga vlerësimi i burimeve të kriterit profesional, duke i përjashtuar dhe nga vlerësimi në referencë të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, në kuadër të procesit të rivlerësimit.

21. Kolegji, në jurisprudencën e tij, sipas përcaktimit të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka dhënë orientimet lidhur me kryerjen e procesit të rivlerësimit, për sa i përket kriterit të aftësive profesionale që lidhen me raste konkrete¹². Kolegji ka vlerësuar se, me qëllimin për të kryer një vlerësim të plotë dhe të gjithanshëm, kur është e mundur dhe e nevojshme [...] *duhet të administrohen të gjitha burimet dhe të vlerësojë të gjitha kriteret, bazuar në treguesit e përcaktuar në ligjin nr. 96/2016 dhe, njëkohësisht, duhet të tregojë mënyrën se si janë administruar burimet dhe janë vlerësuar kriteret, duke konsideruar, ndër të tjera, me rëndësi*

¹⁰ Shihni vendimin (JR) nr. 2/2020, paragrafët 15.2 deri 15.7, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

¹¹ Referohuni vendimit (JR) nr. 2/2020, prg. 32.5, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

¹² Referohuni vendimit (JR) nr. 21/2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

që për vlerësimin e aftësive profesionale, vëmendje t'i kushtohet edhe denoncimit të fakteve nga publiku [...].

22. Rezulton se hetimi i Komisionit, lidhur me kriterin e aftësive profesionale, është bazuar në administrimin e të gjithë burimeve të vlerësimit, verifikimin dhe analizimin e: (i) raportit për analizimin e aftësive profesionale, të mbajtur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë; (ii) vlerësimit të denoncimeve të paraqitura dhe shqyrtimit të dokumentacionit, të administruar që lidhet me çështjet objekt ankimi nga subjektet denoncuese; (iii) vlerësimit dhe analizimit të disa dosjeve të tjera gjyqësore, të shqyrtuara nga subjekti i rivlerësimit, të administruara në vijim të verifikimit të sinjalizimeve të përfituara nga organet e tjera ligjzbatuese; dhe (iv) kriterëve të vlerësimit, të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (neni 71 e vijues i tij).

23. Referuar rezultateve të hetimit administrativ mbi këto akte, Komisioneri Publik çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse, si dhe nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës, mbi gjetjet e rezultuara nga burimet e administruara, të cilat duhet të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit, për sa në vijim:

23.1 Procedimi penal nr.*, me datë regjistrimi **.6.2014**

23.1.1 Më datë **.6.2014, Komisariati i Policisë Lezhë ka përcjellë pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë informacion mbi referimin e veprës penale, ku i ka referuar prokurorit regjistrimin dhe fillimin e procedimit penal për veprat penale: "Goditje për shkak të detyrës" dhe "Kanosje për shkak të detyrës", parashikuar nga neni 237 dhe 238 i K. Penal, në ngarkim të shtetasit ***.***, vepra të kryera në dëm të një punonjësi të Policisë së Shtetit. Referuar këtij informacioni, shtetasi ***.***, nga këqyrja e sistemit TIMS, rezulton person me precedentë penale, i arrestuar për kryerjen e veprave penale: "Prodhim dhe shitje e narkotikëve", "Dhunë në familje", "Pengim për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës", parashikuar nga nenet 283/a; 130/a/1; dhe 320 të K. Penal.

23.1.2 Në datën **.6.2014, mbi bazën e këtij materiali, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal vetëm për veprën penale "Goditje për shkak të detyrës", parashikuar në nenin 237 të Kodit Penal.

23.1.3 Nga aktet e fashikullit të procedimit penal, Komisioni ka konstatuar se janë kryer disa veprime procedurale, të tilla si: (i) në datën **.6.2014 është këqyruar banesa e shtetasit ***.***; (ii) në datën **.6.2014 është pyetur shtetasi ***.***, si person që ka dijeni për veprën penale; (iii) në datën **.7.2014 është pyetur, në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, shtetasi ***.***; (iv) në datën **.7.2014 është pyetur shtetasi ***.*** dhe (v) në datën **.7.2014 shtetasi ***.***, në cilësinë e personave që kanë dijeni për veprën penale.

23.1.4 Me vendimin e datës **.9.2014, "Për zgjatjen e afatit hetimor në procedimin penal ***/2014", subjekti i rivlerësimit ka zgjatur afatin e hetimeve nga data **.9.2014 - **.12.2014, për të kryer disa veprime shtesë, si pyetja e shtetasit ***.*** Më datë **.11.2014 është pyetur ky shtetas si person që ka dijeni për veprën penale.

23.1.5 Në vijim, më datë **.12.2014, subjekti i rivlerësimit ka vendosur sërish zgjatjen e afatit hetimor, nga data **.12.2014 - **.3.2015, për kryerjen e disa veprimeve të tjera hetimore, të cilat kanë mbetur pa u kryer, si pyetja e personave të pranishëm, administrimi i pamjeve filmike në vendin e ngjarjes, si dhe veprime të tjera, që lindin të nevojshme gjatë hetimit.

23.1.6 Me vendimin e datës **.1.2015, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e procedimit penal, bazuar në nenin 328/1 germa “b” të K. Pr. Penale, *për shkak se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale*, ndër të tjera, duke arsyetuar se: [...] *Nga analiza e fakteve dhe provave të administruara për këtë procedim penal ka rezultuar se punonjësi i Policisë, ***, nuk është goditur nga shtetasi ***, pasi kjo vepër penale, nga ana e saj objektive, kryhet nëpërmjet veprimeve aktive... kurse me vepra dhune kuptohen ato vepra që nga karakteri i tyre nuk janë rrahje, por forma të ndryshme dhune..., pra në rastin konkret nuk ndodhemi përpara veprës penale të goditjes për shkak detyre [...].*

23.1.7 Referuar informacionit të përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë **.11.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, ndaj këtij vendimi nuk është ushtruar ankim.

23.1.8 Bazuar në përmbajtjen e akteve të administruara në fashikullin e Komisionit, me aktin e kontrollit të datës **.12.2014, zv. drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë nuk ka qenë dakord me vendimin e marrë nga subjekti i rivlerësimit për pushimin e këtij procedimi, duke lëshuar një raport përfundimtar, në të cilin ka arsyetuar se: [...] *Nuk jam dakord me vendimin...Nuk rezulton të jetë kryer asnjë veprim hetimor procedural pas datës së kontrollit. Gjithashtu, e përsërisim që duhet sqaruar momenti që lidhet me kryerjen e veprimeve nga personi nën hetim ndaj punonjësit të Policisë, i cili, që në momentet e para në kallëzim dhe deklarimin e dhënë, pranon të jetë goditur nga shtetasi ***, më pas para of. pol. gjyq. të Prokurorisë nuk e prezanton këtë fakt. Duhet marrë në konsideratë ky moment, pasi pikërisht mbi bazën e kallëzimit dhe deklarimit të punonjësit të Policisë është marrë në përgjegjësi penale shtetasi ***, person ky i dhunshëm dhe problematik. Gjithashtu, të verifikohen të dhënat përkatëse te salla operative [...].*

23.1.9 Nga administrimi i fashikullit të procedimit penal, Komisioni nuk ka konstatuar kryerjen e ndonjë veprimi procedural tjetër nga subjekti i rivlerësimit, pas datës **.11.2014, për të justifikuar vendimin e marrë për zgjatjen e dytë të afateve të hetimeve nga data **.12.2014 - **.3.2015.

23.1.10 Sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime, pasi, ndër të tjera, i ka rezultuar se: (i) vendimi për zgjatjen e afatit hetimor të datës **.12.2014 nuk i është njoftuar të pandehurit, bazuar në nenin 324 pika 3 e Kodit të Pr. Penale, me qëllim ushtrimin e së drejtës ligjore të ankimit, sipas nenit 325 të Kodit të Pr. Penale. (ii) Nga analizimi i fakteve të kallëzuar nga shtetasi, që kanë dijeni për veprën penale, është konstatuar se ka pasur rrethana që kallëzuesi është ndier i kërcënuar për shkak të ushtrimit të detyrës si oficer policie, por duket se subjekti i rivlerësimit nuk i ka konsideruar këto fakte, duke e regjistruar procedimin penal në ngarkim të shtetasit ***, vetëm për veprën penale: “*Goditje për shkak detyre*”, parashikuar në nenin 237 të Kodit Penal,¹³ dhe jo për “*Kanosje për shkak të detyrës*,”¹⁴ parashikuar në nenin 238 të Kodit Penal¹⁵. (iii) Nga analizimi i vendimit të pushimit të procedimit penal nr. ***/2014, nuk duket që subjekti i rivlerësimit të ketë bërë një analizë të

¹³ Parashikon dënim me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

¹⁴ Parashikon dënim me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

¹⁵ Nga analizimi i fakteve të referuara në kallëzimin e datës **.6.2014, kallëzuesi ka kallëzuar se shtetasi ***, i ka dalë përpara atij, duke ia zënë rrugën dhe jo vetëm e ka goditur, por edhe e ka kërcënuar dhe fyer kallëzuesin, si punonjës policie, për shkak se e kishte ndaluar një natë me parë, gjatë ushtrimit të detyrës si oficer patrulle, pranë Komisarariatit të Policisë Lezhë. Fakte të ngjashme dalin edhe nga deklaratimet e shtetasve ***, dhe ***, të cilët janë pyetur në cilësinë e shtetasve që kanë dijeni për veprën penale. Gjithashtu, edhe nga kolegu i kallëzuesit, shtetasi ***, i cili ka qenë bashkë me kallëzuesin kur është kontrolluar i pandehuri dhe se ka treguar disa fakte që i kishte rrëfyer kallëzuesi, të ndodhura atij, ditën e nesërme, nga shtetasi që i kishin ndaluar një natë përpara, gjatë ushtrimit të detyrës si oficer patrulle.

veprimeve procedurale dhe fakteve të rezultuara nga hetimi, për të dalë në një konkluzion të bazuar në drejtim të përcaktimit të përgjegjësisë penale. (iv) Subjekti nuk ka arsyetuar në lidhje me vendimin për pushimin e procedimit, lidhur me shkakun se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale¹⁶ dhe duket se vendimin e ka bazuar vetëm në deklaratimet e shtetasve që kanë dijeni për veprën penale, pa vlerësuar faktet që dalin nga deklaratimet e tyre, në raport me faktet e deklaruara nga vetë kallëzuesi dhe pa kryer asnjë veprim procedural të nevojshëm, *si administrimi i kamerave të sigurisë, në momentin e ndodhjes së ngjarjes, për kryerjen e të cilit subjekti kishte shtyrë afatin e hetimeve, me vendimin e datës **.12.2014*; (v) Subjekti i rivlerësimit nuk e ka konsideruar faktin se personi nën hetim, shtetasi ***.***, ishte person në kërkim për shkak se ishte i dyshuar për kryerjen e disa veprave penale, referuar raportit TIMS, të administruar nga dosja e hetimit. (vi) Nga analizimi i fakteve të paraqitura në kallëzim me faktet e paraqitura në procesverbalin e datës **.7.2014, nga kallëzuesi, duket se kallëzuesi ka ndryshuar deklarinimin, duke kërkuar në fund të mos ndiqet penalisht shtetasi ***.*** dhe subjekti i rivlerësimit nuk e ka hetuar këtë fakt në lidhje me ndryshimin e deklarinimit. Komisioni ka vërejtur se procesverbali i datës **.7.2014 është nënshkruar në dy versione¹⁷ nga kallëzuesi, ku në njërin version kallëzuesi deklaron se e ka sqaruar konfliktin dhe kërkon të mos ndiqet penalisht, ndërsa në versionin tjetër të procesverbalit, të së njëjtës datë, nuk i deklaron këto rrethana.

23.1.11 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit të Komisionit, ndër të tjera, ka parashtruar se: [...] *Në lidhje me vërejtjet e konstatuara në dosjen e hetimit, ...në përputhje me rregullat e kontrollit të vendimmarrjes në Prokurori, vendimi i pushimit dhe, në tërësi, fashikulli i hetimit paraprak i kalonte për hierarki zëvendës drejtuesit e më pas drejtuesit të Prokurorisë. Duke qenë i bindur në vendimmarrjen përpos mendimit të zëvendës drejtuesit të Prokurorisë, procedimi është përcjellë te drejtuesi i Prokurorisë, i cili, përmes konfirmimit të dosjes penale me nënshkrimin e tij, ka vendosur arkivimin më **.2.2015 [...]*.

23.1.12 Komisioni, pas administrimit të shpjegimeve, të paraqitura nga subjekti me shkrim, pas rezultateve të hetimit dhe verbalisht në seancën dëgjimore, ka vlerësuar se ato nuk janë bindëse¹⁸.

23.1.13 Në përfundim, Komisioni konstaton se veprimet hetimore, të kryera nga subjekti i rivlerësimit, kanë qenë të pamjaftueshme për të konkluduar në pushimin e procedimit penal. Komisioni ka vlerësuar po ashtu se, në kuptim të kriterit profesional, gjetjet e konstatuara në këtë dosje penale nuk e penalizojnë subjektin, sipas nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, bazuar në parimin e proporcionalitetit, duke përbërë shkak për referim pranë organit kompetent për inspektimin e mëtejshëm në kuadër të legjislacionit, që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

23.1.14 Komisioneri Publik, ashtu sikurse Komisioni, ka arsyetuar, vlerëson se subjekti nuk jep shpjegime bindëse mbi gjetjet dhe të metat e veprimeve procedurale të kryera prej tij e të konstatuara në aktet e fashikullit procedural konkret.

23.1.15 Nga aktet e administruara, duket se nuk është zbatuar dhe kërkesa procedurale mbi njoftimin e palëve për zgjatjen e afatit hetimor. Përpos kësaj, edhe qëndrimi i shprehur nga

¹⁶ Subjekti i rivlerësimit është shprehur se në rastin konkret nuk ndodhemi përpara veprës penale të goditjes për shkak detyre, pa analizuar faktet dhe pa shpjeguar se përse veprimet e shtetasit ***.***, ndaj kallëzuesit, shtetasit ***.***, nuk përbëjnë vepër penale. Shihni arsyetimin e subjektit, në faqen 3 të vendimit, për pushimin e procedimit penal, datë **.1.2015.

¹⁷ Shihni procesverbalin e datës **.7.2014, paragrafin e fundit në përgjigje të pyetjes: “Keni gjë tjetër për të deklaruar?”.

¹⁸ Referohuni vendimit të Komisionit, f. 38-39 të tij.

subjekti i rivlerësimit se mosnjoftimi është përgjegjësi e oficerit të Policisë gjyqësore, nuk mund të përbëjë justifikim dhe logjikë për moszbatimin e një detyrimi ligjor.¹⁹

23.1.16 Referuar këtyre të dhënave, Komisioneri Publik konstaton se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në trajtimin e kësaj çështjeje, në kuadër të aspektit të njohurive ligjore, pasi nuk ka ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të konkluduar bazuar në këto elemente, prova dhe ligj, në procedimin penal konkret.

23.1.17 Procedimi penal nr. ***, i vitit 2014, i transferuar nga Komisioni, në zbatim të parashikimit ligjor dhe interpretimit gjyqësor të materializuar në jurisprudencën e Kolegjit, është në tejkalim të afateve kohore, të parashikuara nga neni 117 i ligjit nr. 96/2016.

23.1.18 Komisioneri Publik, për sa ka rezultuar nga hetimi i Komisionit, vlerëson se moskryerja e të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme, mënyra jo e saktë e vlerësimit të fakteve dhe provave, argumentimi jo i plotë dhe jo në përputhje me dispozitat ligjore, bien ndesh me kriteret e parashikuara në nenin 73, pikat 2 dhe 3, dhe 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, dhe duhen të merren nga Kolegji në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

23.2 Procedimi penal nr. ***, datë **.10.2014

23.2.1 Më datë **.6.2014, Komisariati i Policisë Lezhe ka përcjellë pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë informacionin mbi referimin e veprës penale, pasi, me *akt motivimi të veçantë*, është arrestuar në flagrancë shtetasi ***.*** (alias ***.***), pasi dyshohej se kishte konsumuar elementet e veprës penale: “*Plagosje e lehtë me dashje në bashkëpunim*”, të parashikuar nga neni 89 dhe neni 25 i K. Penal.

23.2.2 Me urdhrin e datës **.9.2014, subjekti i rivlerësimit ka regjistruar procedimin penal për veprën penale: “*Plagosja e lehtë me dashje*”, parashikuar nga neni 89 i K. Penal, me të pandehur shtetasin ***.***, ku është urdhëruar dhe kryerja e veprimeve hetimore, me qëllim përcaktimin e faktit penal, si dhe sqarimin e rrethanave të kryerjes së veprës penale.

23.2.3 Në lidhje me këtë procedim penal janë kryer këto veprime hetimore, si: (i) pyetja e kallëzuesit, të personave që kanë dijeni për veprën penale; (ii) kontrolli i banesës së të pandehurit; (iii) njohja e personit me anë të fotografive; (iv) si dhe kryerja e aktit të ekspertimit mjeko-ligjor, datë **.9.2014, ku eksperti ka ardhur në përfundimin se: [...] *dëmtimet e shkaktuara shtetasit ***.*** futen në kategorinë e atyre që kanë sjellë humbjen e aftësisë për punë deri në 9 ditë [...]*.

23.2.4 Në datën **.9.2014 është kryer arrestimi i shtetasit ***.***, si dhe është kryer kontrolli personal i tij. Në datën **.9.2014 është kërkuar vleftësimi i ligjshëm i arrestimit në flagrancë dhe caktimi i masës së sigurimit nga subjekti i rivlerësimit.

23.2.5 Me vendimin nr. ***, datë **.9.2014, Gjykata e Shkallës së Parë, Lezhë ka vendosur pranimin e kërkesës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, duke vleftësuar të ligjshëm arrestin në flagrancë të të dyshuarit ***.***, caktimin e masës së sigurimit personal, detyrim për paraqitje, duke urdhëruar lirin e të arrestuarit nga paraburgimi.

¹⁹ Qëndrim ky i mbajtur dhe në jurisprudencën e Kolegjit, vendimi (JR) nr.19/2021, prg. 31.2.

23.2.6 Me vendimin e datës **.10.2014, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e hetimeve për procedimin penal nr. ***/2014, bazuar në nenin 328, pika 1, germa “f”, pasi vepra penale ndiqet me ankim para Gjykatës nga i dëmtuari, bazuar në nenin 59 të K. Pr. Penale.

23.2.7 Referuar informacionit të përcjellë me shkresën nr. ***/1 prot., datë **.11.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë, ndaj këtij vendimi nuk është ushtruar ankim.

Sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime, pasi, ndër të tjera, i ka rezultuar se: (i) Nga analiza e ligjit të zbatueshëm në raport me faktet e rezultuara, vihet re se subjekti nuk ka bërë cilësimin juridik të duhur të veprës penale, mbi bazën e së cilës ka vendosur pushimin e procedimit penal, pasi sipas ligjit procedural penal ndiqet me ankim të të dëmtuarit. (ii) Në arritjen e këtij konkluzioni, subjekti referon veprën penale: “*Plagosje e lehtë me dashje*”, parashikuar në nenin 89 të Kodit Penal, dispozitë e cila parashikon rastet kur nga dëmtimi është shkaktuar paaftësi e përkohshme në punë më tepër se 9 ditë, ndërkohë dëmtimet të cilat sjellin paaftësi të përkohshme në punë deri në 9 ditë, siç është konkluduar në rastin konkret nga ekspertiza mjeko-ligjore, parashikohen nga neni 90 i Kodit Penal: “*Dëmtime të tjera me dashje*”, të cilat, sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale, ndiqen me kërkesë në Gjykatë nga i dëmtuari, ku Prokurori merr pjesë në gjykimin e këtyre çështjeve dhe, sipas rastit, kërkon dënimin e të pandehurit ose pafajësinë e tij. (iii) Subjekti i rivlerësimit i është referuar edhe një akti ekspertimi teknik, **me nr. **, datë **.7.2014**,²⁰ i cili, referuar datës së lëshimit dhe veprës penale, së cilës i referohet: “*Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik*”, parashikuar nga neni 236 i Kodit Penal, duket se i përket një procedimi tjetër në ngarkim të të njëjtit shtetas, ***.***²¹

23.2.8 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, ka parashtruar se: [...] *Megjithëse nuk rezulton e cituar shprehimisht prej meje (neni 90 i K. Penal), në vendimin e pushimit, rezulton e qartë që ndodhemi para figurës së “Dëmtime të tjera me dashje”, për të cilin Prokuroria nuk ka kompetencë për të vijuar hetimin e nisur, prandaj edhe është proceduar me pushimin e çështjes... Në lidhje me aktin e ekspertimit teknik të sendit të dyshuar shkop bejsbolli, pas regjistrimit të procedimit penal, nga deklaratimet e administruara, ka rezultuar se i dëmtuari është goditur me një send të fortë, të dyshuar shkop bejsbolli, ndërkohë që i proceduari ka deklaruar se nuk ka pasur armë të ftohtë me vete, por sulmin e ka kryer me një shkop, që e ka konstatuar jashtë ambientit ku e ka kryer sulmin [...].*

23.2.9 Komisioni, pasi ka administruar shpjegimet e subjektit në tërësi, në lidhje me këtë procedim, i ka vlerësuar ato bindëse. Subjekti, në shpjegimet e tij, ka pranuar vetë se nuk ka kryer saktësisht cilësimin juridik të veprës penale në vendimin e pushimit të procedimit, por Komisioni ka vlerësuar se kjo pasaktësi nuk e penalizon subjektin, pasi shkakun për të cilin ka pushuar procedimin dhe baza ligjore e përdorur ka qenë e saktë. Gjithashtu, Komisioni ka vlerësuar bindëse shpjegimet e subjektit në lidhje me përdorimin e një akti ekspertimi teknik, që i përkiste një tjetër procedimi penal, në dosjen e procedimit konkret.

23.2.10 Komisioneri Publik ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, pasi në rastin konkret vëren se në aktet e hartuara nga subjekti i rivlerësimit mungon arsyeja ligjore mbi ndryshimin e cilësimit të veprës penale nga ajo e referuar nga oficeri i Policisë gjyqësore: “*Plagosje e lehtë*

²⁰ Sipas të cilit citon se, me akt ekspertimi teknik, me nr. **, datë **.7.2014, është konkluduar se materiali objekt ekspertimi, shkop gome, me përmasa 90 cm, nuk futet në kategorinë e armëve të ftohta.

²¹ I cili, referuar gjeneraliteteve, duket se është i pandehuri në procedimin nr. ***.

me dashje në bashkëpunim”, të parashikuar nga neni 89 dhe 25 i K. Penal, në atë me të cilën ka regjistruar procedimin penal: *“Plagosje e lehtë me dashje*”, parashikuar nga neni 89 i K. Penal, dhe atë me të cilën ka vendosur pushimin e ndjekjes së kësaj veprë penale, si: *“Dëmtime të tjera me dashje*”, parashikuar nga neni 90 i K. Penal, si vepra që duhet të ndiqen kryesisht në Gjykatë.

23.2.11 Referuar këtij qëndrimi, arsytimi i subjektit mbi përdorimin e një akt ekspertimi që i përket një procedimi tjetër, më të hershëm në kohë, mbi një mjet të pretenduar se mund të jetë kryer vepra penale, nuk mbështetet nga rrethanat, deklaratimet dhe aktet në dosje, e për më tepër përmbajtja e të dhënave të këtyre akteve procedurale, mbi natyrën e mjetit (armë e ftohtë) është kontradiktore. Po ashtu, arsytimi në lidhje me kryerjen e veprës penale në kushtet e parashikuara nga neni 25 i Kodit Penal, mungon.

23.2.12 Këto mangësi në kryerjen e veprimeve hetimore dhe arsyetimin e akteve procedurale, duket kanë sjellë pasoja në mbrojtjen e posaçme ligjore të marrëdhënieve juridiko-shoqërore të rëndësishme (shëndetit të shtetasve), si dhe eventualisht në të drejtat procedurale të të dëmtuarit nga kryerja e veprës penale.

23.2.13 Në këto rrethana, Komisioneri Publik vlerëson se gjetjet mbi këtë procedim penal janë të tilla që duhen vlerësuar në raport me indikatorët e nenit 73, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, më së paku, në raport me treguesit e cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik të prokurorit.

23.3 *Procedimi penal nr. ***, datë **.11.2020*

23.3.1 Referuar indicieve të marra nga autoritetet verifikuese, Komisioni ka administruar disa fashikuj penal²², të cilat ka vlerësuar t’i konsiderojë dhe të hetojë në lidhje me to, bazuar në nenin 41/4 të ligjit nr. 84/2016, ndër to dhe procedimi penal nr. ***/2020.

23.3.2 Më datë **.11.2020, Drejtoria Vendore e Policisë së Shtetit, Lezhë ka përcjellë pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë, informacion në të cilin, ndër të tjera, referon materialet për veprën penale të: *“Drejtim automjeti në mënyrë të parregullt*”, në gjendje të dehur dhe *“Mosbindje ndaj urdhrin të punonjësit të Policisë së rendit publik*”, të parashikuar nga nenet 291 dhe 242 të K. Penal, në ngarkim të shtetasit ***.***, i arrestuar në flagrancë në gjendje të dehur, në drejtim të mjetit motorik, i cili dhe nuk ka pranuar t’i bindet urdhrave të punonjësve të Policisë, për t’u ndalur²³.

23.3.3 Me urdhrin e datës **.11.2020, subjekti i rivlerësimit ka regjistruar procedimin penal vetëm për veprën penale: *“Drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt*”, në ngarkim të shtetasit ***.***, duke parashtruar se, në datën **.11.2021, nga shërbimet e Policisë është konstatuar se drejtuesi i mjetit, me targë ***, shtetasi ***.***, po lëvizte me mjetin e tij pranë vendit të quajtur “***”, pranë Bashkisë Lezhë, nën efektin e pijeve alkoolike. Po në këtë datë,

²² Me shkresën me nr. *** prot., datë **.1.2022, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë dhe shkresë me nr. *** prot., datë **.2.2022, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Lezhë; shkresë me nr. *** prot., datë **.2.2022, u kërkuar dosjet e plota hetimore dhe informacion në lidhje me statusin e këtyre çështjeve në gjykatën kompetente.

²³ Nga vlerësimi i dosjes hetimore konstatohen edhe disa fakte të tjera në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e të pandehurit ndaj urdhrave të punonjësve të Policisë, të cilat nuk janë hetuar nga subjekti i rivlerësimit. Konkretisht, referuar raportit të shërbimit, datë **.11.2020, të lëshuar nga punonjësit e Policisë të shërbimit, Lezhë, që kanë qenë në turn ditën e ngjarjes, është shkruar se: “Rreth orës 1.30 po patrullonim në rrugën “***”, i bëmë shenjë ndalimi automjetit me targa: ***, tip Mercedes Benz .. nuk ndalon dhe tentoi duke bërë manovra të rrezikshme dhe u largua në drejtim të “***” me shpejtësi, e ndoqëm dhe përballë “***”, u fut në një parkim, fiku automjetin, zbriti nga automjeti dhe u fsheh poshtë një makine tjetër... i bëmë thirrje disa herë që do të shoqërohet, pasi kundërshtonte që të vinte me ne. Pas shumë përpjekjeve për ta bindur, kemi arritur të bëjmë shoqërimin e tij me metoda të buta, së bashku me automjetin në Komisarriatin e Policisë, Lezhë”.

subjekti i rivlerësimit ka kërkuar *vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal, detyrim për paraqitje, sipas nenit 234 K. Pr. Penale.*

23.3.4 Me vendimin nr. ***, datë **.11.2020, Gjykata e Shkallës së Parë, Lezhë ka vendosur pranimin e kërkesës për vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë të shtetasit ***,***, caktimin e masës detyrim për paraqitje, si dhe lirimin e këtij shtetasi nga dhomat e paraburgimit.

23.3.5 Në vijim të kryerjes së veprimeve procedurale, subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 301/2 të K. Pr. Penale, ka vendosur vleftësimin e sekuestros së provave materiale (*automjet, leje qarkullimi, policë sigurimi, printim nga sistemi e-gjoba mbi të dhënat e lejes së drejtimit, certifikatë kontrolli teknik, me nr. ***) dhe, më datë **.11.2020, ka urdhëruar kthimin e tyre.*

23.3.6 Subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 201/a, pika 10²⁴ e K. Pr. Penale: “*Marrja e detyrueshme e kampionëve biologjikë*”, ka vendosur²⁵ marrjen e kampionëve të gjakut pranë Spitalit Rajonal Lezhë, me qëllim kryerjen e ekspertimit për përcaktimin e nivelit të alkoolit në gjak, të shtetasit ***,***, ku, në zbatim të vendimit, është kryer sekuestrimi²⁶ i kampionëve të gjakut dhe i janë dërguar ekspertit toksikolog për kryerjen e ekspertimit toksikologjik. Me aktin toksikologjik-ligjor nr. *** datë **.11.2020, është konkluduar se: [...] *në mostrën e gjakut të marrë shtetasit ***,*** është zbuluar alkool etilik, në vlerën mesatare 1.751 gr/l [...].*

23.3.7 Në datën **.11.2020, Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë, në vendimin nr. *** për shqyrtimin e kundërvajtjes administrative, ka konstatuar: [...] *Drejtuesi i mjetit drejton mjetin nën ndikimin e pijes alkoolike. Nuk i ndalon kur i jepet shenja për ndalim nga patrulla e Policisë rrugore, si dhe nuk pranon të bëjë testin për përdorimin e pijes alkoolike. Pa leje drejtimi me vete [...].*

23.3.8 Pasi janë kryer edhe veprimet e tjera hetimore, si: (i) pyetja²⁷ e të pandehurit dhe (ii) administrimi i disa akteve²⁸, subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës **.12.2020, ka vendosur për marrjen si të pandehur të shtetasit ***,***, për veprën penale: “*Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt*”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal dhe njoftimin e akuzës.

23.3.9 Subjekti i rivlerësimit, me kërkesën e datës **.12.2020, ka vendosur dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. ***/2020. Me vendimin nr. ***, datë **.3.2021, Gjykata e Shkallës së Parë, Lezhë ka vendosur, ndër të tjera: [...] *1. Deklarimin fajtor të të pandehurit për kryerjen e veprës penale: “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me tre muaj burgim. 2. Në aplikim të nenit 406 të K. Pr. Penale i ulet 1/3 e dënimit me 2 muaj burgim. 3. Pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien e tij në provë për një periudhë 4 mujore, duke detyruar të pandehurin të mos kryejë veprën tjetër penale dhe të mbajë kontakte me Zyrën e Shërbimit të Provës së vendbanimit të tij [...].*

23.3.10 Sa më sipër, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi, ndër të tjera, i ka rezultuar se: (i) referuar nenit 242 të Kodit Penal,

²⁴ Në raste të ngutshme, kur ka arsye për të besuar se vonesa mund të shkaktojë humbjen ose dëmtimin e vërtetësisë së provës, vendimi merret nga Prokurori, i cili mund të urdhërojë shoqërimin e detyrueshëm të personit.

²⁵ Me vendimin datë **.11.2020. Ky vendim është marrë nga subjekti i rivlerësimit, duke vlerësuar rrethanat e refuzimit të personit të ndaluar për kryerjen e testit të alkoolit.

²⁶ Referuar “Procesverbalit për marrjen dhe sekuestrimin e kampionit të gjakut”, datë **.11.2020.

²⁷ Sipas procesverbalit të datës **.12.2020.

²⁸ Shkresë, informacion i marrë nga DPSHTRR-ja, në lidhje me disponimin e lejes së drejtimit për shtetasin ***,***.

parashikohet se: [...] *Mosbindja ndaj urdhrave të ligjshëm të punonjësit të Policisë së rendit publik përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj [...].* (ii) Duke vlerësuar këto fakte dhe veprimet hetimore të kryera në lidhje me këtë çështje, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka hetuar mbi faktet e veprimeve dhe mosveprimeve të shtetasit ***.*** ndaj urdhrave të punonjësve të Policisë që kanë qenë në shërbim gjatë kohës së patrullimit të këtij shtetasi me automjetin e tij, si dhe as nuk ka arsyetuar se përse është i mjaftueshëm dërgimi për gjykim i të pandehurit për akuzën e vetme në ngarkim të tij: “*Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt*”. (iii) Moskryerja e një hetimi të plotë nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me faktet e dokumentuara, duket se ka sjellë për pasojë lehtësimin e pozitës së të pandehurit.

23.3.11 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, ka parashtruar se: [...] *të gjitha elementet e veprimeve dhe mosveprimeve të të dyshuarit konkret në këtë procedim penal, përbënin elementet e figurës së veprës penale të: “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” (në gjendje të dehur), sipas parashikimit të nenit 291 të Kodit Penal dhe se, nga ana tjetër, veprimet e konstatuara në lidhje me mospranimin e kryerjes së matjes së alkoolit, përmes aparaturës, është vlerësuar dhe çmuar si një sjellje, e cila nuk shkonte në drejtim të mosbindjes ndaj urdhrave të Policisë për verifikimin e alkoolit ... Çmuarja e provave në bazë të bindjes së brendshme është konsideruar dhe vleftësuar e bazuar edhe nga Gjykata, e cila, në përfundim, ka bërë vendimmarrjen përkatëse, që shkon në përputhje me qëndrimin dhe kërkimin e Prokurorisë [...].*

23.3.12 Në përfundim, Komisioni, ndër të tjera, arrin në përfundimin se: [...] *Subjekti arriti të shpjegojë bindshëm në lidhje me gjetjet e Komisionit. Nëpërmjet procedurës së ndjekur për matjen e alkoolit për të pandehurin, ai shpjegoi se, pavarësisht se ka pasur kundërshtime nga ana e të pandehurit ndaj urdhrave të punonjësve të Policisë, këto kundërshtime lidhen me përpjekjet e tij për mos iu bindur kryerjes së testit të alkoolit dhe, në këtë kuptim, refuzimi i të pandehurit për ta kryer testin, nuk përbën vepër penale [...].*

23.3.13 Komisioneri Publik, për sa janë administruar në akte në dosjen e Komisionit vlerëson se subjekti nuk arrin të provojë të kundërtën e barrës së provës. Regjistrimi i procedimit penal, me cilësim ndryshe nga veprat penale të referuara nga Policia e Rrethit, Lezhë, duket se kanë mundësuar lehtësimin e pozitës procedurale të shtetasit ***.***.

23.3.14 Refuzimi për t’iu bindur urdhrave të Policisë, bazuar në rrethanat e referuara në aktet procedurale, të hartuara për efekt të këtij procedimi penal, nuk lidhet me refuzimin për realizimin e testit të alkoolit, por, sikundër parashtrohet në akte, është realizuar nëpërmjet veprimeve konkrete, duke refuzuar shtetasi ***.***, për t’u ndalur përpara shenjave të Policisë, si dhe kryerja e manovrave të rrezikshme në drejtim, me qëllim për t’iu shmangur shërbimeve policore.

23.3.15 Sa më sipër, Komisioneri Publik konstaton se nga të dhënat e administruara si rezultat i *informacioneve të organeve ligjzbatuese*, duket se rezultojnë disa rrethana, të cilat, të analizuara së bashku me rezultatet e tjera të hetimit në vlerësimin e aftësive profesionale, si dhe të para në raport me njëra-tjetrën, duhen çmuar nga Kolegji, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

23.4 Procedimin penal nr. ***, datë **.7.2017

23.4.1 Shtetasit ***, dhe ***.*** pretendojnë se janë hetuar dy herë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë (*procedimi penal nr. ***/2015 dhe procedimi penal nr. ***/2017*), si dhe janë deklaruar fajtor dy herë për të njëjtin fakt nga Gjykata e Shkallës së Parë, Lezhë për veprën penale të “Mashttrimit”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, për të njëjtat fakte, bazuar në një procedim penal të dytë, të regjistruar për të njëjtat fakte dhe të njëjtat vepra penale, të regjistruara, hetuara dhe dërguar për gjykim nga subjekti i rivlerësimit.

23.4.2 Në lidhje me hetimin dhe gjykimin e shtetasve ***, nga aktet e administruara në fashikullin e Komisionit, ka rezultuar se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë mbi bazën e kallëzimit të shtetasit ***.***, të datës **.2.2014, ka regjistruar procedimin *penal nr. ****, në ngarkim të shtetasve ***. dhe ***.***, për veprën penale të “Mashttrimit”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal dhe, pas përfundimit të hetimeve, janë dërguar për gjykim, për kryerjen e kësaj vepre penale.

23.4.3 Gjykata e Shkallës së Parë, Lezhë, *me vendimin nr. ***, datë **.3.2017*, ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurve **. dhe ***.*** Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin *nr. ***, datë **.10.2017*, e ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës e Shkallës së Parë, Lezhë, në lidhje me fajësinë për të pandehurën ***.***, duke ndryshuar vendimin e duke deklaruar të pafajshëm të pandehurin ***.***.

23.4.4 Nga aktet ka rezultuar se, pa u shqyrtuar ende çështja e mësipërme nga Gjykata e Apelit Shkodër, kallëzuesi ***.*** paraqet një kallëzim tjetër penal ndaj të njëjtëve shtetas, ***. dhe ***.*** Në vijim, ky kallëzim regjistrohet pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë, *me nr. procedimi nr. ***, datë **.7.2017*, në ngarkim të të pandehurve ***. dhe ***.***, për veprën penale të “Mashttrimit”, parashikuar nga neni 143/2 i K. Penal, duke u kryer veprimet përkatëse procedurale nga ana e subjektit të rivlerësimit.

23.4.5 Pas përfundimit të hetimeve, çështja është dërguar për gjykim pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë. Kjo e fundit, me *vendimin nr. ***, datë **.10.2019*, ka vendosur të deklarojë fajtorë dy të pandehurit, për veprën penale të “Mashttrimit”, të kryer në bashkëpunim, duke i dënuar të dy me një masë dënimi prej 5 (pesë) vite burg.

23.4.6 Mbi bazën e ankimit të të pandehurve, shtetasve ***, çështja është gjykuar nga Gjykata e Apelit Shkodër, e cila, me vendimin *nr. ***, datë **.9.2020*, ka vendosur prishjen e vendimit *nr. ***, datë **.1.2019*, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Lezhë dhe pushimin e çështjes.

23.4.7 Gjykata e Apelit Shkodër ka konstatuar se të dyja procedimet penale e në vijim gjykimet përkatëse kanë pasur për objekt të njëjtin fakt penal, duke vlerësuar se në rastin konkret vepron parimi “*ne bis in idem*”, pasi subjektet, shtetasit ***, janë gjykuar për të njëjtat veprime dhe të njëjtat pasoja të shkaktuara nga këto veprime, përkundrejt së njëjtës ngjarje, të gjykuar më parë me vendimin *nr. ***, datë **.3.2017*, duke qenë kështu në kushtet kur nuk lejohet fillimi i procedimit penal dhe meqë ndjekja penale është ushtruar, nuk lejohet as vazhdimi i procedimit penal, pasi, me vendim të formës së prerë, të pandehurit ***. dhe ***.***, janë gjykuar një herë për të njëjtin fakt penal.

23.4.8 Sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të paraqesë qëndrimin e tij në lidhje me këtë çështje, si dhe të shpjegojë se mbi bazën e cilave rrethana ka paraqitur akuzën në gjyq ndaj shtetasve ***, në konkluzionet përfundimtare për procedimin penal *nr. ***/2017*.

23.4.9 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, ka parashtruar se: [...] *Sikurse rezulton nga rrethanat e faktit të rezultuara nga hetimi i kryer në procedimin penal nr. ***/2017, akuza nga ana e Prokurorisë është ngritur dhe arsyetuar në bazë të faktit se, ndryshe nga sa ishte hetuar dhe shqipëruar vendimi më i hershëm, nr.***, datë **.3.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Lezhë, ndryshuar pjesërisht me vendimin nr.***, datë **.10.2017, të Gjykatës së Apelit Shkodër, në rastin konkret ishte zbardhur dhe verifikuar mashtrimi mbi një vlerë tjetër monetare, e cila ishte transferuar nga i dëmtuari i veprës penale në favor të bashkëshortëve ***. Mbi këtë shumë monetare të dërguar dhe dokumentuar përmes sistemin bankar, të pandehurit në shpërdorim të besimit dhe tagrave të përfaqësimit, kanë lidhur kontrata dhe blerë pasuri kundrejt çmimeve fiktive, me motivin e qartë të përvetësimit për vete shumat e dërguara, ndërkohë që, nga ana tjetër, kanë mashtruar dërguesin mbi destinimin dhe mënyrën e përdorimit të parave [...].*

23.4.10 Komisioni, pasi analizoi faktet nga dosja e hetimit dhe shqyrtoi shpjegimet e subjektit, i vlerësoi ato bindëse, ndër të tjera, arsyeton se: [...] *Nga administrimi i fakteve të rezultuara për efekt të procedimit penal nr. ***/2017, është konstatuar se hetimi penal është nisur nga kallëzimi i shtetasit ***. mbi bazën e disa fakteve të reja të konstatuara gjatë një procesi civil, të nisur po nga ai kundrejt shtetasve ***, me objekt, ndër të tjera, “lirim, dorëzim prone”, sipas të cilit kanë rezultuar fakte që lidheshin me shumat të tjera monetare. Trupi gjykues, në këtë kontekst, vlerëson se, pavarësisht se Gjykata e Lartë nuk është shprehur ende në lidhje me këtë çështje, për sa konstatohen rrethana të cilat pas hetimit përfaqësojnë një fakt penal tjetër të ri, qoftë kundrejt të të njëjtave palë, për të njëjtën veprë penale, këto fakte nuk përbëjnë gjë të gjykuar [...].*

23.4.11 Komisioneri Publik, në referencë të vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër, nr.***/2020, i cili, ndër të tjera, ka argumentuar se: [...] *Pra në të dyja akuzat rezulton edhe specifikimi si në lidhje me faktin e mashtrimit, duke përvetësuar pasurinë monetare të së njëjtës viktimë, ***,***, për blerjen e të njëjtave pasuri, ashtu dhe mënyra dhe koha në të cilën janë marrë....se Prokuroria sipas nenit 290, pika 1 shkronja e e K. Pr. Penale, nuk duhej të fillonte ushtrimin e ndjekjes penale për të njëjtat fakte për të cilat shtetasit ***. dhe ***.*** ishin gjykuar njëherë, pasi i tillë pushtet ishte konsumuar më parë me ushtrimin e ndjekjes penale në ngritjen e parë të procesit para Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë e që ka përfunduar me vendim të formës së prerë....veprimi i parimit “ne bis in idem” nuk lejon vazhdimin e procedimit [...]; vlerëson se shpjegimet e subjektit dhe bazueshmëria e vendimit të Komisionit mbi to, nuk gjejnë mbështetje në ligj.*

23.4.12 Situata faktike të procedimit penal, të ndjekur nga subjekti i rivlerësimit, në vlerësim të rrethanave të hetuara më parë nga kjo Prokurori, lidhur me veprimet hetimore, vlerësimin e provave dhe aktet e administruara, do të duhet të vlerësohen referuar indikatorit të parashikuar nga neni 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

23.5 Procedimi penal nr. ***, datë **.3.2015

23.5.1 Komisioni ka vlerësuar të hetojë, gjithashtu, rrethanat e parashtruara nga ana e shtetasit ***.***, i cili, përveç veprimeve të përsëritura në organet kompetente të ushtrimit të ndjekjes penale²⁹, në kuadër të procesit të rivlerësimit, ka paraqitur në Komision një denoncim³⁰.

23.5.2 Nga ana e Komisionit, referuar denoncimit të administruar prej tij, janë verifikuar veprimet hetimore të subjektit të rivlerësimit në çështjen penale nr. ***/2015, të regjistruar në emër të shtetasit ***.***, për veprën “Kanosja e gjyqtarit”, parashikuara nga neni 317 i Kodit Penal.

23.5.3 Më datë **.3.2015, në Prokurorinë Lezhë, është administruar një zarf, brenda të cilit kanë qenë dy letra drejtuar ish-drejtesit të Prokurorisë Lezhë, z. ***.***, dhe subjektit të rivlerësimit, me përmbajtje kërcënuese.

23.5.4 Pasi janë kryer verifikimet e para, rezulton se është caktuar si prokuror për hetimin në lidhje me këto letra subjekti i rivlerësimit, i cili, më datën **.3.2015, ka regjistruar procedimin penal me nr. ***, në ngarkim të shtetasit ***.***, për veprën penale: “Kanosja e gjyqtarit”, dhe në vijim është urdhëruar ndalimi i tij, që është ekzekutuar në datën **.3.2015.

23.5.5 Gjykata e Shkallës së Parë Lezhë, me vendimin nr. ***, datë **.3.2015, ka vleftësuar të ligjshëm ndalimin dhe ka caktuar ndaj shtetasit ***.*** masën *detyrim për paraqitje*. Në vijim, subjekti i rivlerësimit, me vendimin datë **.4.2015, ka vendosur moskompetencën dhe kalimin e akteve Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë për hetime të mëtejshme³¹.

23.5.6 Mbi bazën e ankimit të shtetasit ***.***, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë **.4.2015, ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. ***, datë **.3.2015, me arsyetimin se: [...] *vendimi për caktimin e masës së sigurimit është marrë mbi bazën e akteve absolutisht të pavlefshme, bazuar në nenin 128 të K. Pr. Penale, pasi subjekti i rivlerësimit kishte interes të drejtpërdrejtë në këtë çështje, dhe sipas nenit 17 dhe 26 të K. Pr. Penale duhet të hiqte dore [...]*.

23.5.7 Sa më sipër, Komisioni ka argumentuar se: [...] *pa u ndalur te pasojat e veprimeve procedurale të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit, të cilat duket se janë rregulluar nga gjykata më e lartë, e cila, me shpalljen si të pavlefshme të akteve procedurale, ka vendosur edhe shfuqizimin e vendimit të gjykatës me të ulët, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi i ka rezultuar se subjekti, nëpërmjet angazhimit/pranimi për hetimin e një çështjeje penale, në të cilën referohej emri i tij, në rrethanat ku, bazuar në nenin 17, pika 1, shkronja “a”, dhe nenin 26 të Kodit të Procedurës Penale, kishte detyrimin të hiqte dorë nga hetimi i çështjes penale, pasi kishte interes të drejtpërdrejtë në të, ka cenuar standardet e etikës dhe vlerave profesionale që duhet të manifestojë një magjistrat te publiku për garantimin e një drejtësie të paanshme [...]*.

²⁹ Referohuni Raportit të aftësive profesionale, të hartuar nga KLP-ja, f. 36, si dhe rezultateve të hetimit dhe akteve të administruara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, Prokuroria e Rrethit Kurbin, si dhe fashikullit “Denoncime në dosje të Komisionit”.

³⁰ Denoncim, regjistruar me nr. *** prot., datë **.11.2021, si dhe me nr. *** prot., datë **.1.2022, i shtetasit ***.***.

³¹ Pas përfundimit të hetimeve, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, lidhur me procedimin e kaluar për kompetencë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë, me vendimin e datës **.6.2015, ka vendosur pushimin e hetimeve për veprën penale: “Kanosja e gjyqtarit”, me autor të dyshuar shtetasin ***.***.

23.5.8 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, ka parashtruar se: [...] *si prokuror, nuk e kam konsideruar asnjëherë veten si subjekt i përfshirë, qoftë në pretendimet e kallëzimit dhe as si i interesuar, në kuptim të nenit 17/1/a të K. Pr. Penale dhe prandaj nuk kam qenë në kushtet e nenit 17 të K. Pr. Penale [...].* Për të provuar në lidhje me çështjen e konfliktit të interesit, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provave disa akte, sipas të cilave, vërtetohet se subjekti nuk ka hetuar ndonjëherë çështje në lidhje me shtetasit e cituar në kallëzim.

23.5.9 Komisioni, pasi administroi shpjegimet e subjektit, ndër të tjera, ka arritur në përfundimin se: [...] *në lidhje me këtë çështje janë konstatuar rrethana, të cilat, sipas legjislacionit në fuqi, ndalojnë ushtrimin e veprimtarisë hetimore. Neni 17, pika 1, shkronja "a", dhe 26, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale rregullon detyrimin e prokurorëve për heqjen dorë nga hetimi i çështjes, në rastin kur ka interes në procedim... trupi gjykues çmon se këto rrethana nuk e bëjnë subjektin të papërshtatshëm për kriterin profesional, bazuar në parimin e proporcionalitetit, për sa subjekti, në një kohë shumë të shkurtër, mori masa për heqjen dorë nga shqyrtimi i themelit të çështjes, duke ia kaluar për kompetencë prokurorisë më të afërt. Në çmim të këtij trupi gjykues vlerësohet gjithashtu se praktika që lidhet me ankesën e shtetasit ***.*** duhet të përcillet pranë organit kompetent për inspektimin e mëtejshëm, në kuadër të legjislacionit, që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve [...].*

23.5.10 Komisioneri Publik, sa më sipër konstatuar, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë të kundërtën e barrës së provës. Në këto rrethana të pranuar edhe nga Komisioni, procedimi penal nr.***, i vitit 2015, nuk duhej të transferohej për inspektim të shkeljeve pranë organit kompetent, të juridiksionit të zakonshëm disiplinor, pasi është në tejkalim të afateve kohore të parashikuara nga neni 117 i ligjit nr. 96/2016.

23.5.11 Gjetjet dhe rrethanat e konfliktit të interesit, të konstatuara nga Komisioni në këtë çështje, duhen vlerësuar së bashku me gjetjet e tjera, në kuadër të vlerësimit etik dhe profesional të subjektit të rivlerësimit, në referencë të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

23.6 Procedimin penal nr. ***, datë **.9.2018

23.6.1 Më datë **.9.2018, Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë i ka referuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë, materialet procedurale në ngarkim të shtetasit ***.***, për veprat penale: *"Prodhim dhe shitje të narkotikëve"* dhe *"Mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve shpërthyes dhe i municionit"*, të parashikuara nga neni 283 dhe 278/5 të K. Penal.

23.6.2 Bazuar në përmbajtjen e këtij referimi, rezulton se në vijim të veprimeve hetimore që lidhen me procedimin penal nr. ***, viti 2018, nga ana e shërbimeve policore është kapur në flagrancë shtetasi ***.***, referuar me gjendje gjyqësore i dënuar më parë, identifikuar me anë të sistemit TIMS, pasi në bagazhin e automjetit të tij transportonte lëndë narkotike të llojit marihuana³² dhe lëndë plasëse, për t'u shpërthyer në distancë nëpërmjet telefonisë së lëvizshme.

23.6.3 Pas përfundimit të hetimeve për këtë procedim penal dhe dërgimit të çështjes për gjykim, në kushtet e zhvillimit të gjykimit të shkurtuar, subjekti i rivlerësimit, më datë **.7.2019, ka paraqitur diskutimet përfundimtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë, ku ka kërkuar: [...] (i)- *deklarimin fajtor të të pandehurit për veprën penale: "Prodhim dhe*

³² Nga ky akt rezulton se janë peshuar tri paketime të shënuara me numër me materialin bimor dhe ka rezultuar: 1- me peshë 1095 gr; 2 - me peshë 969,5 gr; dhe 3- me peshë 821, 5 gr, në total në peshën 2 kg e 886 gr.

shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 dhe dënimin e tij me 5 vite burgim; (ii)-deklarimin fajtor të të pandehurit për veprën penale: “Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/5 të K. Penal, dhe dënimin e tij me 5 vite burgim; (iii) - Në bazë të nenit 55 të K. Penal, në caktimin e dënimeve për disa vepra penale, dënimin e të pandehurit me një dënim prej 5 vite burgim; (iv) - Në aplikim të nenit 406/1 të K. Pr. Penale të pandehurit i ulet 1/3 e dënimit, duke e dënuar përfundimisht me 3 vite e 4 muaj burgim; (v)- në mbështetje të nenit 59 të K. Penal urdhërohet pezullimi i dënimit me burgim për pjesën e pavuajtur të dënimit me kusht që i pandehuri të mos kryejë veprë tjetër penale, si dhe të mbajë kontakte me Zyrën e Shërbimit të Provës Tiranë, për një periudhë prej 5 vitesh; (vi) -Në zbatim të kërkesave të nenit 60, pika 9, dhe 10 të K. Penal, të urdhërohet i pandehuri që të mos shoqërohet me persona të dënuar, si dhe të mos mbajë apo përdorë armë [...].

23.6.4 Gjykata e Shkallës së Parë, Lezhë, me vendimin nr. ***, datë **.10.2019, ka vendosur, sipas kërimit të organit të Prokurorisë, përfaqësuar nga subjekti i rivlerësimit, në lidhje me cilësimin juridik të veprave penale, me ndryshimin që, në bazë të nenit 55 të K. Penal, ka dënuar të pandehurin me një dënim prej 6 (gjashtë) vite burgim, e në zbatim të nenit 406/1 të K. Pr. Penale e ka dënuar përfundimisht me 4 (katër) vite burgim. Ky vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë ka marrë formë të prerë, duke mos ushtruar ankim palët pjesëmarrëse në gjykim.

23.6.5 Komisioni, pasi ka vlerësuar denoncimin e administruar për këtë procedim dhe përfaqësimin e akuzës në gjykim, bazuar në nenin 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, i ka kërkuar subjektit të shpjegojë në lidhje me çështjet vijuese: (i) cilat vepra penale janë referuar nga Policia para Prokurorisë Lezhë dhe për cilat vepra penale është kryer regjistrimi i procedimit, duke paraqitur rrethanat e çështjes mbi bazën e të cilave është kryer regjistrimi; (ii) Si e keni arsyetuar ju kërkimin tuaj para Gjykatës për dënimin e të pandehurit prej 5 vitesh burgim, si dënimi më i rëndë i shtuar, në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal³³, në rrethanat kur për secilën nga të dyja veprat penale keni kërkuar që i pandehuri të dënohet përkatësisht me nga 5 vite burgim; (iii) Cilat kanë qenë shkaqet ku jeni bazuar për të kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim për të pandehurin dhe vënien e tij në provë për një periudhë prej 5 vitesh, në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal.

23.6.6 Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime për çështjet e mësipërme, në parashtrimet e rezultateve të hetimit të datës 21.3.2022. Duket se arsyetimi i Komisionit në vendimin e tij, në lidhje me gjetjet për këtë procedim penal, është vetëm pjesë e prg. 83.1, ku argumentohet se, në kuadër të një sërë denoncimeve, nuk u gjetën indicie për hetime të mëtejshme, në lidhje me kriterin profesional për subjektin e rivlerësimit.

23.6.7 Komisioneri Publik vlerëson se gjetjet e rezultateve të hetimit, dhe mbi këtë procedim penal, duhen t’i nënshtrohen juridiksionit rivlerësues të Kolegjit, më së paku, lidhur me analizën dhe arsyetimin logjik të prokurorit mbi aplikimin e nenit 55 të K. Penal, lidhur me referimin e dënimit më të rëndë të shtuar, si dhe ekzistencën e kushteve për zbatimin e nenit 59 të K. Penal, në drejtim të indikatorëve të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, duke u vlerësuar në referencë të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

³³ Kur veprimet ose mosveprimet përbajnë elementet e disa veprave penale, si dhe kur personi ka kryer disa vepra penale për të cilat nuk është dhënë akoma vendim. Gjykata më parë cakton dënimin për çdo veprë penale dhe, në përfundim, jep një dënim të vetëm, që përbëhet nga dënimi më i rëndë i shtuar.

23.7 Procedimin penal nr. ***, datë **.12.2020

23.7.1 Shtetasi ***.***, në kuadër të procesit të rivlerësimit, ka depozituar një ankim në Komision, duke pretenduar, ndër të tjera, se subjekti, në procedimin penal nr. ***, datë **.12.2020, nuk ka kryer hetime të plota dhe se është mundur të fshehtë të vërtetën e ngjarjes, duke mos ushtruar ndjekjen penale për subjektet kryesore, shkaktare për vrasjen e të birit të tij, të ndjerin ***.***, i vrarë në datën ** dhjetor 2020, por ka ngritur akuza ndaj disa shtetasve të tjerë.

23.7.2 Shtetasi ***.*** pretendon po ashtu se nuk është njoftuar për vendimet e marra nga subjekti i rivlerësimit, në zbatim të neneve 58 dhe 327 të K. Pr. Penale dhe se njoftimi ndaj tij është kryer vetëm nga ana e Gjykatës.

23.7.3 Bazuar në këtë denoncim, Komisioni ka administruar aktet e procedimit penal dhe i kanë rezultuar këto rrethana fakti:

23.7.4 Në datën **.12.2020 në fshatin ***, Lezhë, është gjetur i vrarë me armë zjarri, në automjetin e tij shtetasi ***.***, me detyrë efektiv në RNSH, Shkodër. Sipas njoftimit të marrë nga Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë dhe pas kryerjes së veprimeve të para hetimore, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. ***/2020, për veprat penale të: *“Vrasjes me paramendim”* dhe *“Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”*, parashikuar nga neni 78/1 dhe 278/1 të Kodit Penal.

23.7.5 Më tej, pas kryerjes së veprimeve të para hetimore në lidhje me këtë ngjarje dhe pas këqyrjes së pamjeve filmike, të sekuestruara përgjatë aksit rrugor, ku ka ndodhur ngjarja, është bërë i mundur identifikimi i personit të dyshuar, i quajtur ***.***, i cili, nga verifikimet në sistemin TIMS, është larguar nga Shqipëria në drejtim të Kosovës një ditë pas ngjarjes, nëpërmjet pikës kufitare Morinë, si dhe i shtetasit ***.*** Mbi bazën e këtyre rrethanave, subjekti i rivlerësimit, më datë **.12.2020, ka urdhëruar regjistrimin në regjistrin e njoftimit të veprave penale për këtë procedim penal, emrat e personave nën hetim, të dyshuar për kryerjen e veprave penale: *“Vrasje me paramendim”* dhe *“Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”*.

23.7.6 Në vijim, ka rezultuar se mbi bazën e materialit të referuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë, më datë **.12.2020, Prokuroria Lezhë ka regjistruar procedimin penal për veprat penale *“Kanosje”*, *“Prishje e qetësisë publike”* dhe *“Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”*, ndaj shtetasve ***.*** dhe ***.***, pasi dyshohen se në datën **.12.2020, në aksin rrugor Lezhë Milot, në afërsi të karburantit “***”, kanë qëlluar drejt këtij karburanti me armë zjarri, duke shkaktuar dëme materiale.

23.7.7 Në lidhje me këtë çështje, nga ekspertimi tekniko-balistik i gjurmëve të gëzhjojave model të qitjes me metoda krahasuese³⁴, bazuar në aktin nr. ***, datë **.1.2021, “Ekspertim tekniko-balistik”, është konstatuar përputhje me gjurmët e gëzhjojave të kalibrit për vrasjen e shtetasit ***.***, më datë **.12.2020, në Lezhë.

23.7.8 Mbi bazën e konkluzionit tekniko-balistik, subjekti i rivlerësimit, më datë **.1.2021, ka vendosur bashkimin e procedimit penal me nr. ***/2020 me procedimin penal nr. ***/2020 në një procedim të vetëm, atë me nr. ***/2020. Më tej, për kryerjen e veprimeve të mëtejshme

³⁴ Në aktin në faqen 251 të fashikullit citohet: Krahasimi i gjurmëve në gëzhhojat model krahasues u krye me imazhet e gjurmëve të formuara në gëzhhojat e fishekëve të kalibrit 7,62x39 mm dhe 7,62x 25 mm, të regjistruar në databazë deri më datë **.1.2021.

hetimore në lidhje me këtë procedim, subjekti i rivlerësimit ka disponuar me vendime për zgjatje afati hetimor për një periudhë totale prej 1 (një) viti³⁵.

23.7.9 Nga administrimi i dosjes hetimore, Komisioni ka vërejtur se subjekti i rivlerësimit ka kërkuar, më datë **.12.2020, para Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë, caktimin e masës së sigurimit arrest në burg për të dyshuarit ***.*** dhe ***.***, si të dyshuar për kryerjen e veprave penale: “*Vrasje me paramendim*” dhe “*Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit*”, e cila është pranuar nga Gjykata me vendimin nr. **, datë **.12.2020³⁶. Në datën **.12.2020, subjekti i rivlerësimit i ka dërguar Prokurorisë së Përgjithshme urdhrin për kërkim ndërkombëtar³⁷ për shtetasin ***.*** dhe në vijim, në datën **.4.2021, i ka dërguar sërish të dhëna Prokurorisë së Përgjithshme, me qëllim përditësimin e praktikës së shpalljes për kërkim ndërkombëtar.

23.7.10 Më tej, me urdhrin për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale datë **.12.2021, (Komisioni referon të panënshkruar nga subjekti i rivlerësimit) urdhëron ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga “*Vrasje me paramendim*”, parashikuar nga neni 78, prg. i parë i K. Penal³⁸, në “*Vrasje me dashje*”, parashikuar nga neni 76 i K. Penal³⁹.

23.7.11 Pas kryerjes së veprimeve hetimore, më datë **.12.2021, subjekti i rivlerësimit ka vendosur dërgimin në gjyq të çështjes penale⁴⁰ nr. ***/2020, me të pandehur ***.***, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Vrasje me dashje*” dhe “*Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit*”, në dy raste: rasti i parë për vrasjen e shtetasit ***.***, në datën **.12.2020 dhe rasti i dytë ngjarja e datës **.12.2020, për veprën penale të “*Kanosjes*” dhe “*Prishje e rendit dhe qetësisë publike*”, si dhe në ngarkim të shtetasit ***.***, akuzuar për veprën penale “*Përkrahje e autorit të krimit*”.

23.7.12 Sa më sipër, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës, për çështjet vijuese: (i) vërehet se subjekti në katër vendimet e marra për zgjatjen e afatit ka përsëritur në mënyrë standarde veprimet hetimore të përgjithshme, që duhet të kryhen, por pa arsyetuar pamundësinë objektive për t’i përfunduar brenda afatit dhe nevojën për zgjatjen e afatit me vendimin përkatës për periudhën e caktuar, bazuar në nenin 324/2 e K. Pr. Penale; (ii) Vërehet se, me kërkesën e datës **.12.2021 (të panënshkruar nga subjekti i rivlerësimit), subjekti i rivlerësimit ka kërkuar pushimin e hetimeve në ngarkim të shtetasit ***.***, me të vetmin arsyetim se: [...] nga të gjitha veprimet hetimore të kryera, provat e administruara, nuk mund të provohet që shtetasi ***.*** të ketë kryer vrasjen e shtetasit ***.*** [...], por referuar dosjes hetimore, nuk duket që subjekti i rivlerësimit të ketë kryer ndonjë veprim hetimor që të justifikonte pushimin e hetimeve në ngarkim të tij; (iii) Vërehet se në urdhrin e marrë për ndryshimin e cilësimit të veprës penale, subjekti nuk ka arsyetuar se cilat kanë qenë rrethanat mbi bazën e të cilave ka vendosur ndryshimin e cilësimit të veprës penale nga “*vrasje me paramendim*”, në “*vrasje me dashje*”; (iv) Vërehet se subjekti i

³⁵ Nga referimet e Komisionit në rezultatet e hetimit administrativ, rezultojnë se periudhat në të cilat janë zgjatur afatet janë konkretisht: (1) Me vendimin e datës **.3.2021 është vendosur zgjatje afati hetimor nga data **.3.2021-**.6.2021; (2) Me vendimin e datës **.6.2021 është vendosur zgjatje afati hetimor nga data **.6.2021-**.9.2021; (3) Me vendimin e datës **.9.2021 është vendosur zgjatje afati hetimor nga data **.6.2021-**.12.2021; (4) Me vendimin e datës **.12.2021 është vendosur zgjatje afati hetimor nga data **.12.2021-**.3.2022.

³⁶ Komisioni referon se ky vendim i është dërguar për zbatim Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, ku konstatohet se është zbatuar vetëm ndaj shtetasit ***.***.

³⁷ Shihni volumnin 2 të procedimit penal, f. 597 e vijuese.

³⁸ Dënohet me burgim nga 15 deri në 25 vjet.

³⁹ Dënohet me burgim nga 10 deri në 20 vjet.

⁴⁰ Komisioni ka referuar se kërkesa është e panënshkruar nga subjekti.

rivlerësimit ka nënshkruar shkresën përcjellëse për dërgimin e njoftimit, për përfundimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***/2020, babait të viktimës z. ***.***, por nuk identifikohet nëse i është dërguar atij dhe nuk provohet nëse babai i viktimës ka marrë dijeni në lidhje me përfundimin e hetimeve, me qëllim që të ushtrojë të drejtat e tij sipas nenit 327 të K. Pr. Penale, pasi njoftimi nuk ka ekstremitetet e duhura të një akti zyrtar (datë dhe nr. protokolli) dhe nuk i është bashkëlidhur mandati i postës bashkë me lajmërim-marrjen e njoftimit.

23.7.13 Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet e tij në përgjigje të rezultateve të hetimit⁴¹, duke pretenduar paraprakisht se, në bazë të nenit E, pika 2, të aneksit të Kushtetutës, vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim.

23.7.14 Në lidhje me statusin e kësaj çështje, Gjykata e Shkallës së Parë, Lezhë⁴² ka njoftuar se pranë kësaj gjykate ka ardhur për shqyrtim kërkesa për gjykim e datës **.12.2021, në lidhje me procedimin penal nr. ***/2020, në ngarkim të shtetasve ***.*** dhe ***.***, si dhe kërkesa për pushim të hetimeve, e datës **.12.2021, në ngarkim të shtetasve ***.*** dhe ***.*** Gjykata në fjalë ka informuar Komisionin se, nga verifikimet e kryera në sistemin ICMIS, rezulton se në lidhje me këtë çështje është regjistruar kërkesa penale me nr. ***/210, akti dhe numër elektronik ***-2021 dhe se kjo çështje është aktualisht në shqyrtim pranë kësaj gjykate në fazën e seancës paraprake.

23.7.15 Për sa më lart, Komisioni pasi ka vlerësuar shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti dhe, pas verifikimeve në lidhje me statusin e kësaj çështje, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi dhe në orientimet e dhëna nga Kolegji⁴³ në lidhje me çështjen në shqyrtim, çmon se kontrolli i aftësisë profesionale nuk mund të kryhet për këtë çështje, sipas pikës 2, të nenit E, të aneksit të Kushtetutës, pasi, për rrjedhojë, do të paragjykohej zgjidhja e një çështjeje në shqyrtim nga subjekti i rivlerësimit.

23.7.16 Ndërsa në lidhje me kryerjen e veprimeve procedurale nga ana e subjektit të rivlerësimit për njoftimin e babait të viktimës, Komisioni i referohet shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, duke gjetur të provuar se njoftimi procedural ishte kryer bazuar në administrimin e kopjes së njësuar të fletës së *“librit të korrespondencës me postën sekrete”*.

23.7.17 Komisioneri Publik, në konsideratë të jurisprudencës së Kolegjit⁴⁴, vlerëson t'i përfshijë edhe çështjet e verifikuara gjatë hetimit administrativ nga Komisioni lidhur me veprimet procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit, në procedimin penal nr.***, datë **.12.2020, si shkaqe të këtij ankimit, të cilat do të duhen vlerësuar në drejtim të indikatorëve të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, në referencë të vendimmarrjes përfundimtare eventuale të juridiksionit gjyqësor, gjatë gjykimit të këtij ankimi në Kolegji, duke i kërkuar këtij të fundit t'i marrë në shqyrtim bazuar në nenin 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

23.8 Në përfundim të shkaqeve të ankimit të trajtuar më sipër, në zbatim dhe të jurisprudencës së Kolegjit, për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe etikës së subjektit të rivlerësimit, vlerësojmë se të metat e konstatuara në shqyrtimin e çështjeve të

⁴¹ Referohuni f. 45-51, të rezultateve pas riçeljes së hetimit, në dosje të Komisionit.

⁴² Korrespondencë elektronike e mbajtur me Kancelaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, datë **.3.2022, dhe kthim përgjigjeje datë **.3.2022.

⁴³ Komisioni në vendim, në referencën me nr. 123, ka cituar vendimin (JR) nr. 33, datë 3.11.2021.

⁴⁴ Referohuni vendimit (JR) nr.27/2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, prg.19.15.

trajtuara gjatë procesit, duhet të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

III. Kërkimi i ankimit

24. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës dhe aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, për kriteret e rivlerësimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

25. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

26. Nisur nga fakti se Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit;

27. Bazuar në nenin Ç, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, Kreun VI dhe nenin 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016;

28. Komisioneri Publik kërkon që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 521, datë 1.4.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Erjon Shehaj.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA